



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
SHKOLLA SHQIPTARE E ADMINISTRATËS PUBLIKE
DREJTORIA E ZHVILLIMIT DHE VLERËSIMIT TË CILËSISË

Nr. 220/13 prot.

Tiranë, më 21 . 02 . 2025

NJOFTIM PËR HAPJEN E THIRRJEVE
PËR HARTIM KURRIKULE DHE DHËNIE TRAJNIMI

Në bazë të vendimit nr. 138, datë 12.3.2014 “Për rregullat e organizimit e të funksionimit të Shkollës Shqiptare të Administratës Publike, trajnimin e nëpunësve civilë, si dhe të çdo individi tjetër jashtë shërbimit civil” (I ndryshuar me vkm nr. 349, datë 4.6.2014, vkm nr. 70, datë 27.1.2016, vkm nr. 687, datë 18.11.2021 si dhe vkm nr. 22 dt. 09.01.2025).

Shkolla Shqiptare e Administratës Publike shpall njoftimin për “HAPJEN E THIRRJEVE PËR HARTIM KURRIKULE DHE DHËNIE TRAJNIMI” si më poshtë vijon :

Thirrje për ekspertë për hartim kurrikule dhe dhënie për temën “**Hyrje në Remote Sensing**”:

Detyrat kryesore:

- Trajneri duhet t’u përmbahet të gjitha instruksioneve, kriterëve, udhëzimeve të përgjithshme dhe vërejtjeve teknike që do të bëhen nga shkolla.
- ASPA zotëron të drejtën ekskluzive të autorit për kurrikulën e trajnimit ndaj trajnerit ndalohet të riprodhojë apo përdorë kurrikulën pa autorizimin e Shkollës Shqiptare të Administratës Publike.
- Trajneri përpara fillimit të trajnimit duhet të paraqesë tek menaxheri i trajnimit dosjen e trajnimit ku përfshihen objektivat, rezultatet e të nxënësve, çështjet teknike që do të trajtojnë me referencë të plotë burimore, matricën didaktike shoqëruar me anekse të detajuara të aktiviteteve që do të zhvillojë gjatë trajnimit.
- Trajnerit i njihet e drejta që brenda kuadrit të objektivave të trajnimit, rezultateve të pritshme të të nxënësve dhe kufijve teorik të çështjeve që mbulon trajnimi, të propozojë një matrice didaktike sa më efektive.

- Në çdo rast trajneri duhet të sigurojë që banka e pyetjeve që disponon shkolla është e përshtatshme për kontributin e njohurive të trajtuara në klasë gjatë trajnimit. Nëse konstatohet se banka e pyetjeve nuk është e plotë, trajneri duhet të propozojë pyetje shtesë në përputhje me përmbajtjen e trajnimit të zhvilluar prej tij në klasë.

Kandidatët e interesuar për hartim kurrikule duhet të përmbushin këto kritere:

- Diplomë “Master i Shkencave” ose “Master i Arteve” ose “Master Profesional të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike” apo të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, dhe mbi 11 vite përvojë pune në fushën përkatëse për të cilën do të ofrojnë trajnimin ose trajnerët që kanë një gradë apo titull shkencor. ose;
- Trajnerë të kategorisë së veçantë që kanë një diplomë të arsimit të lartë apo të barasvlershme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë që jetojnë dhe punojnë jashtë Shqipërisë apo janë kthyer në Shqipëri jo më herët se 2 vjet nga momenti i kontraktimit nga ASPA dhe kanë të paktën 4 vite përvojë pune në institucione/organizata/kompani ndërkombëtare jashtë vendit, të lidhura me fushën përkatëse për të cilën do të ofrojnë trajnimin ose do të hartojnë kurrikulën.

Kandidatët e interesuar për dhënie trajnimi duhet të përmbushin këto kritere:

- Diplomë “Master i Shkencave” ose “Master i Arteve” ose “Master Profesional”, të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike apo të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, të paktën 3 vite përvojë pune në fushën përkatëse për të cilën do të ofrojnë trajnimin

Dokumentet e nevojshme për aplikim janë:

- Curriculum vitae (ku të jetë e specifikuar qartë eksperiencia në fushën përkatëse);
- Letër shprehje interesi.

Dorëzimi i dokumentacionit për aplikim mund të bëhet në mënyrë elektronike nëpërmjet dërgimit të tyre në e-mailin zyrtar aspa@aspa.gov.al, në mënyrë fizike pranë protokollit të ASPA si edhe nëpërmjet postës zyrtare në adresën e institucionit, brenda datës **03.03.2025**.